



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1373/ 11 prot.

Datë 11.06.2026

**V E N D I M**  
**Nr. 793 /2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Anila Malaj      | Anëtar     |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Gjergj Mersini   | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 11.06.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

- Objekt:** Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.675/2026, datë 20.05.2026, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, Mallra, me Nr. REF-83014-04-22-2026, me objekt: “Sistem i Parkimit për “Vlora Parking”, me fond limit 14,294,667 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 11.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK me NIPT M31904013D. Adresa: “Rruga e Dibrës”, Vila 153, Kati I, Z.K. nr.8370,1001, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Vlorë.  
Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Rr. “Osman Haxhiu”, Vlorë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Rrethanat e çështjes*

I.1. Me Vendimin Nr.675/2026, datë 20.05.2026 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar nga autoriteti kontraktor të ankesës së operatorit ekonomik “QuantXIT Solutions” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, Mallra, me Nr. REF-83014-04-22-2026, me objekt: Sistem i Parkimit për “Vlora Parking”, me fond limit 14,294,667 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 11.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
  2. Të pranojë pjesërisht pretendimet e ankesës për procedurën e prokurimit sipërcituar.
  3. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentet e procedurës së prokurimit sipas konstatimeve të këtij Vendimi me publikimin e shtojcës përkatëse.
  4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë KPP-në mbi zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
  5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “QuantX IT Solutions” SHPK.
  6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën ardhur me nr. 8811/6 prot., datë 22.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1373/8 prot., datë 28.05.2026, autoriteti kontraktor, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 675/2026, datë 20.05.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

### **Arsyeton**

II.1. Me shkresën ardhur me nr. 8811/6 prot., datë 22.05.2026, protokolluar me tonën nr. 1373/8 prot., datë 28.05.2026, autoriteti kontraktor, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 675/2026, datë 20.05.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit sipërcituar.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatohet se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën përkatëse për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit, në zbatim të vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik.

II.2. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor Bashkia Vlorë, ka zbatuar vendimin Nr. 675/2026, datë 20.05.2026 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos**

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur”, Mallra, me Nr. REF-83014-04-22-2026, me objekt: “Sistem i Parkimit për “Vlora Parking”, me fond limit 14,294,667 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 11.05.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

